

VENDIM
Nr.532, datë 7.7.2010

PËR PJESËMARRJE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE, NË SHTABE TË NDRYSHME NË AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë të marrin pjesë në këto misione ushtarake, në Afganistan:

1.1 Në Shtabin ISAF (Shtabi i Bashkuar Operacional dhe Shtabi Qendror), Kabul, Afganistan.

- Misioni: Planëzimi, monitorimi dhe kontrolli i veprimtarisë operationale të njësive të ISAF-it.

- Numri i pjesëmarrësve, 3 (tre) ushtarakë.

- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi, Kabul, Afganistan.

- Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Gjermani/Itali-Afganistan është përgjegjësi e NATO-s, ndërsa Shqipëri-Gjermani/Itali dhe anasjelltas është përgjegjësi e palës shqiptare.

1.2 Në Shtabin NTM-A (NATO Training Mission-Afghanistan)

- Misioni: Edukimi dhe trajnimi i personelit të Forcave të Ushtrisë Afgane (ANA), pranë Komandës Afgane.

- Numri i pjesëmarrësve, 5 (pesë) ushtarakë.

- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi, 4 (katër) ushtarakë në Kabul dhe 1 (një) ushtarak në Herat, Afganistan.

1.3 Në Shtabin PRT (Provincial Reconstruction Team)

- Misioni: Kontribut në rindërtimin e institucioneve dhe organizmave të sigurisë në Afganistan.

- Numri i pjesëmarrësve, 2 (dy) ushtarakë.

- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi, Pole-Khomri, Afganistan.

- Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Hungari-Afganistan është përgjegjësi e palës hungareze, ndërsa Shqipëri-Hungari dhe kthim është përgjegjësi e palës shqiptare.

1.4 Në Komandën Rajonale të Veriut “ISAF” (ISAF RC North)

- Misioni: Oficer shtabi për hartimin dhe ndjekjen e procedurave standarde në Shtabin e ISAF-it, në veri të Afganistanit.

- Numri i pjesëmarrësve, 3 (tre) ushtarakë.

- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi, Mazar-E-Sharif, Afganistan.

- Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Gjermani-Afganistan është përgjegjësi e NATO-s, ndërsa Shqipëri-Gjermani dhe kthim është përgjegjësi e palës shqiptare.

1.5 Në “ENDURING FREEDOM” Komanda e Koalicionit për Transferim dhe Siguri (CSTC-A).

- Misioni: Kontribut për transferimin dhe sigurinë e personelit të Forcave të Ushtrisë Afgane (ANA), pranë Komandës Afgane.

- Numri i pjesëmarrësve, 4 (katër) ushtarakë.

- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi në Kabul, Afganistan.

- Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Gjermani-Afganistan është përgjegjësi e palës amerikane, ndërsa Shqipëri-Gjermani dhe kthim është përgjegjësi e palës shqiptare.

1.6 Në ekipet e këshillimit dhe trajnimit (OMLT).

- Misioni: Këshillim dhe trajnim i personelit të shtabit të Brigadës së Parë, të Komandës Rajonale të Veriut (korpusi 209), e dislokuar në veri (Mazar-El-Sharif) të ushtrisë afgane.

- Numri i pjesëmarrësve, 1 (një) ushtarakë.

- Kohëzgjatja, deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj.

- Venddislokimi, Mazar-E-Sharif, Afganistan.

- Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Gjermani-Afganistan është përgjegjësi e palës gjermane, ndërsa Shqipëri-Gjermani dhe kthim është përgjegjësi e palës shqiptare.

2. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për ushtarakët pjesëmarrës në këto operacione, shpenzimet për:

- shpërblimin që do të marrin këta ushtarakë për vështirësi shërbimi, në masën 9000 (nëntë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

- siguracion jete;

- mbivendosje;

- shpenzime telefonike;

- shërbime postare;

- shpenzime telefonike emergjente;

- evakuim mjekësor;

- trajtim mjekësor;

- çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë sipas tabelës bashkëlidhur dhe përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha